



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**  
*(Përfundimtar)*

**PËR**  
**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL**

**NJËSIA BASHKIAKE NR.1**

**Tiranë, Korrik 2015**

## RAPORT

### Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil Njësia Bashkiake Nr.1, Tiranë

#### Hyrje

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, dhe planit të mbikëqyrjes miratuar me vendimin nr. 19, datë 11.03.2015 *"Për miratimin e planit vjetor të punës së institucionit"*, me Vendimin nr. 35, datë 23.04.2015 *"Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Njësia Bashkiake nr.1, Tiranë"*, vendosa fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e qeverisjes vendore, Njësia Bashkiake Nr.1, Tiranë.

Mbikëqyrja u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes nr. 331/2 prot., datë 23.04.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, program i cili i është njoftuar institucionit përkatës me shkresën nr. 331 prot., datë 23.04.2015, *"Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes"*.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilat evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione në shërbimin civil, deklarimin e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, respektimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, hartimin e formularit të përshkrimit të punës, miratimin e planit vjetor të pranimin në shërbimin civil, plotësimin e pozicioneve të punës të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm, pezullimin nga shërbimi civil, realizimin e vlerësimeve të punës për nëpunësit civil, kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove, si dhe probleme të tjera të cilat kanë lindur gjatë zbatimit në praktikë të ligjit për nëpunësin civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i mbikëqyrjes, i përbërë nga Altin Shumeli, Ledina Zhupa dhe Dorina Nika, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, Arbana Basha, realizoi përpunimin e të dhënave dhe përgatiti projektraportin *"Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin, Njësia Bashkiake nr.1, Tiranë"*, i cili iu dërgua për njohje institucionit me shkresën nr. 331/3, dt. 01.07.2015, *"Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e administratës vendore, Njësia Bashkiake nr.1, Tiranë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil"*. Pas marrjes së projektraportit në fjalë, Njësia Bashkiake nr.1, Tiranë, me shkresën nr. 2425/1, dt. 07.07.2015, *"Mbi projektraportin e mbikëqyrjes në Njësinë Bashkiake Nr.1, Tiranë"*, ka përcjellë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil observacionet dhe masat e marra nga ky institucion dhe projektraportin e firmosur nga Kryetari dhe drejtuesi i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të Njesisë Bashkiake nr.1, Tiranë.

## **Qëllimi i mbikëqyrjes:**

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit.
- Paralajmërimi i institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

## **Objekti i mbikëqyrjes:**

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
  - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
  - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit Civil*", apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
  - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
  - Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil;
  - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve.
  - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
  - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
  - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar,

- Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
  5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.
  6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe institucionit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
  7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
  8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
  9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm të Disiplinës, etj.*).
  10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).
  11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
  12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njësisë përgjegjëse*), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes:**

Grupi i mbikëqyrjes përdori si metodë pune verifikimin në subjekt të dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivin e institucionit, si dhe në sektorin e financës, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht, realizoi një takim me personin e kontaktit, Përgjegjësën e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, \*\*\*\*\* , gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakort në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim;
- Verifikoi pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së institucionit;
- Verifikoi procedurat e rekrutimit sipas procedurave konkurruese, të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”;
- Verifikoi procedurat e rekrutimit dhe dosjet individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme që duhet të plotësojnë nëpunësit për pranimin në shërbimin civil;

- Verifikoi dhe analizoi përshkrimet e punës për çdo pozicion pune, për të verifikuar nëse janë hartuar në përputhje me formën dhe përmbajtjen e formatit standart të miratuar me akt nënligjor;
- Verifikoi të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si niveli arsimor, përvoja në punë, etj;
- U administrua dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listëpagesat për periudhën shkurt – mars 2014, mars – prill 2015, listëprezencat e punonjësve.

Konstatimet e procesit të mbikëqyrjes janë materializuar si anekse më vete të organizuar në formën e tabelave dhe janë pjesë përbërëse e këtij raporti.

**1. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimi.**

**a. Vlerësimi i procesit të ndarjes së pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në institucion, sipas strukturës aktuale.**

Njësia Bashkiake Nr. 1 Tiranë, është organ i qeverisjes vendore, statusi i të cilës përcaktohej në ligjin nr. 8654, dt. 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", i ndryshuar. Në nenin 13 të këtij ligji përcaktohet se: "Organet e njësisë bashkiake dhe administrata e tyre përfitojnë të drejta, si ato të bashkive të tjera të vendit, përsa i përket trajtimit të tyre". Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.3.2004, në Kreun II, nenet 5 dhe 6, e përcakton bashkinë si njësi të qeverisjes vendore, dhe për këtë arsye, hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e përfshin këtë institucion në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil. Në nenin 2 të ligjit është përcaktuar në mënyrë të shprehur se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore. Për rrjedhojë, njësitë bashkiake të Tiranës përfshihen në fushën e shërbimit civil.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, në Bashkinë e Tiranës, funksionojnë 11 njësi bashkiake të qeverisjes vendore, dhe administrata e tyre e ushtron veprimtarinë e saj mbi bazën e strukturës organizative, miratimi i së cilës është kompetencë e Këshillit Bashkiak Tiranë, sipas parashikimeve të nenit 32, shkronja "ç" të ligjit nr. 8652, dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar.

Struktura organizative dhe organigrama e Njesisë Bashkiake nr. 1, Tiranë, është miratuar me vendimin nr. 18, datë 26.01.2001 të Këshillit Bashkiak, Tiranë "Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës", ndryshuar në vijimësi në rend kronologjik me vendimin nr. 10, dt. 21.03.2005 "Mbi disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 18, dt. 26.01.2001 "Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës"; vendimin nr. 5, dt. 05.02.2007 "Për caktimin e njësive bashkiake si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, si dhe për një shtesë në numrin e punonjësve në strukturën organizative"; vendimin nr. 20, dt. 30.04.2007 "Për kalimin e disa kompetencave njësive bashkiake dhe një ndryshim në numrin e punonjësve të Njësive Bashkiake dhe Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të

*punëtorëve të qytetit"; vendimin nr. 23 dt. 09.04.2013 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.17, dt. 28.02.2013 "Mbi politikën e decentralizimit të disa kompetencave ligjore pranë organeve të Njësive Bashkiake të Tiranës, si dhe një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 20, dt. 30.04.2007 "Për kalimin e disa kompetencave Njësive Bashkiake dhe një ndryshim në numrin e punonjësve të Njësive Bashkiake dhe Drejtorisë së përgjithshme nr. 1, të punëtorëve të qytetit" (i ndryshuar)"".*

Në përputhje me sa më sipër, struktura organizative e Njesisë Bashkiake Nr. 1, Tiranë, përfshin gjithsej 24 pozicione pune.

Në mbështje të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", shërbimi i gjendjes civile, ushtrohet si funksion i deleguar në organet e qeverisjes vendore. Në përputhje me nenin 62 të ligjit të sapopërmendur dhe Vendimit nr. 1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/ komuna dhe në degët e qarqeve", Zyra e Gjendjes Civile pranë Njesisë Bashkiake nr 1 të Tiranës, përfshin 4 pozicione pune nga të cilat, 1 Përgjegjës Zyre dhe 3 Specialistë.

Sa më sipër, numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës pranë Njesisë Bashkiake nr.1 të Tiranës është 28 (njëzet e tetë).

Rezulton se në institucionin e mbikëqyrur, sipas strukturës së miratuar nga Këshilli Bashkiak Tiranë, 14 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil, ndërsa 10 pozicionet e tjera trajtohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, dt. 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë klasifikimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", Vendimit nr. 1619, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", i ndryshuar, Vendimit nr. 1, datë 18.02.2015, të Këshillit të Njesisë Bashkiake "Për miratimin e buxhetit të Njesisë Bashkiake nr.1 për vitin 2015", pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, ndahen në këto kategori:

1. Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese, në të cilën përfshihen 3 (tre) pozicione pune "Përgjegjës Sektori", dhe më konkretisht pozicionet:
  - Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Ekonomike;
  - Përgjegjës i Sektorit të Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore;
  - Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban;
2. Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, në të cilën përfshihen 11 (njëmbëdhjetë) pozicione pune, nga të cilat 7 pozicione pune i përkasin pozicionit "Specialist i mesëm" dhe 4 pozicione pune i përkasin pozicionit "Specialist i ulët", dhe më konkretisht pozicionet:
  - 7 pozicione "Specialist i mesëm"

- *Ekonomist*
- *Llogaritar – arkëtar*
- *Specialist urban*
- *Specialist infrastrukture*
- *Përgjegjës i zyrës së ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale*
- *Jurist*
- *Specialist i taksave*
- **4 pozicione "Specialist i ulët"**
  - *2 pozicione specialist në zyrën e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale*
  - *Specialist për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*
  - *Specialist i informimit qytetar*

Nga të dhënat e mbledhura rezultojnë se 84 % e nëpunësve, pjesë e shërbimit civil pranë këtij institucioni janë femra dhe 16 % e tyre meshkuj. Moshë mesatare e nëpunësve pjesë e shërbimit civil në këtë institucion është 43 vjeç, ndërkohë që në pjesën më të madhe të tyre, formimi akademik i përket fushës së shkencave ekonomike dhe asaj juridike.

Duke u nisur nga natyra e punës dhe kategorizimi i pagave për pozicionet e renditura më sipër, konstatohet se pozicione pune që i përkasin kategorisë ekzekutive të nëpunësve civilë, në pozicionin "specialist", në strukturën organizative të institucionit paraqiten me emërtime të tilla si "jurist"; "ekonomist"; "llogaritar", të cilat në fakt përfaqësojnë profesionin e kërkuar dhe jo emërtimin e pozicionit të punës në përputhje me klasat dhe nivelet e parashikuara në ligj. Nga përmbajtja e Vendimit nr. 142, dt. 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" dhe konkretisht, të Lidhjes nr. 3 "Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës", e cila është pjesë e këtij vendimi, rezultojnë se, emërtimi i pozicioneve të punës të kategorisë ekzekutive, realizohet duke i klasifikuar pozicionet e punës sipas profesioneve, apo sipas grupeve të ngjashme të punës. Pozicione të tilla si, "Jurist", "Ekonomist", "Specialist urban", "Specialist infrastrukture", "Specialist i taksave", "Llogaritar – arkëtar", sipas këtij akti nënligjor, përfshiheshin në grupin e administrimit të posaçëm, të cilat, në kuptim të ligjit, kërkojnë njohuri të posaçme për realizimin e detyrave funksionale.

**Konkluzion:** Sa parashtruar më sipër, Komisioneri vlerëson se struktura organizative për administratën e institucionit të mbikëqyrur është e organizuar mbështetur në parimin e hierarkisë, në përmbajtjen e saj prezantohen niveli i funksionarëve politikë, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë. Numri i punonjësve për çdo njësi organizative është brenda kufirit të miratuar. Gjithashtu në kuadër të rekomandimeve të Komisionerit të parashtruara në projektraportin dërguar Njësisë Bashkiake Nr.1, Tiranë, lidhur me detyrimin për të njehsuar pozicionin e punës "Llogaritar-arkëtar", subjekti i mbikëqyrur ka reaguar në kohë dhe me UrdhrinUrdhrin nr. 57, dt. 07.07.2015, ka urdhëruar njehsimin e pozicionit të punës në aktin e deklarimit të statusit të punësimit me nr. 1853/1 prot., dt.15.03.2014 për znj.Violeta Lamçe nga "llogaritar - arkëtar" në "Specialiste llogaritar – arkëtare".

**2. Plotësimi i kushteve ligjore për të përfitur statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**

Njësia Bashkiake nr. 1, Tiranë, përfshihet në fushën e veprimit të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Për këtë arsye, deklarimi si nëpunës civil ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, "Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë";
- pika 4, "nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji";
- pika 6, "Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit".

Gjithashtu, Vendimi nr. 116, dt. 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" parashikon se:

- Kreu II "Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet", në pikën 1 përcakton se: "Nëpunës civilë", sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
- Kreu III "Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komuna" në pikën 1 të tij përcakton se "Punonjës ekzistues", sipas pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna, dhe:
  - a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil; apo
  - b) janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se një vit, janë nëpunës civilë për shkak të ligjit".

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarimin e statusit të punësimit, grupi i kontrollit ka verifikuar dhe analizuar:



- materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën e institucionit në fuqi në momentin e mbikëqyrjes;
- listëprezencën e muajit shkurt-mars 2014 dhe listëprezencën e muajit prill 2015;
- kohëzgjatjen e periudhës së punësimit;
- dokumentacionin që vërteton procedurën e marrjes në punë në pozicione të shërbimit civil, si dhe dokumentet personale të punonjësve.

Në momentin e mbikëqyrjes njësia përgjegjëse kishte nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit vetëm për 9 nëpunës të Njesisë Bashkiake nr. 1 Tiranë, si më poshtë:

- në 4 raste është deklaruar statusi i punësimit "*nëpunës civil*";
- në 5 raste është deklaruar statusi i punësimit "*nëpunës civil në periudhë prove*".

Ndërsa për 9 nëpunës të tjerë njësia përgjegjëse nuk ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit.

Pas analizës së situatës lidhur me statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni, bazuar në strukturën analitike që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton sa më poshtë:

2.1. Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në ligjin nr. 8549/1999 "*Statusi i nëpunësit civil*"

Njësia Bashkiake nr. 1, Tiranë, është institucion që ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", tashmë i shfuqizuar. Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësve, rezulton se në këtë institucion janë zhvilluar 12 procedura konkurimi, duke respektuar kërkesat e ligjit 8549/1999 "*Statusi i nëpunësit civil*". Ndërkohë, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në datën 26.02.2014, në 6 raste konstatohen punonjës, të cilët kanë vijuar të mbajnë pozicione pune të shërbimit civil. Aktualisht, në marrëdhënie pune pranë Njesisë Bashkiake nr.1, Tiranë, janë 4 nëpunës (1 nëpunës ka ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të dorëheqjes, ndërsa 1 tjetër, për shkak të plotësimit të moshës së pensionit), të cilët janë:

1. \*\*\*\*\* - në pozicionin e punës "*Jurist*";
2. \*\*\*\*\* - në pozicionin e punës "*Specialist i informimit qytetar*";
3. \*\*\*\*\* - në pozicionin e punës "*Specialist finance për buxhetin dhe kontabilitetin*" (Aktualisht në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Ekonomike).
4. \*\*\*\*\* - në pozicionin e punës "*Specialist në Zyrën e Përkrahjes Sociale*" (nënshtruar procedurave të konkurimit për pozicionin Përgjegjës i Zyrës së Përkrahjes Sociale).

U konstatua se në aktet e emërimit është përdorur emërtesa "*Specialist finance për buxhetin dhe kontabilitetin*", ndërkohë që në strukturën e kësaj njësie emërtesa për këtë pozicion është "*Ekonomiste*".

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, njësia përgjegjëse rezulton të ketë deklaruar statusin e punësimit *nëpunës civilë*, për nëpunësit e mëposhtëm, të cilët kryenin funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të sipërpërmendur dhe që kanë qenë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil":

1. \*\*\*\*\* , Akt deklarimi i statusit të nëpunësit civil nr. 157/1 prot. datë 15.03.2014 në pozicionin "Jurist";
2. \*\*\*\*\* , Akt deklarimi i statusit të nëpunësit civil nr. 17/1 prot. datë 15.03.2014 në pozicionin "Specialist i informimit qytetar";
3. \*\*\*\*\* , Akt deklarimi i statusit të nëpunësit civil nr. 541/1 prot. datë 15.03.2014 në pozicionin "Specialist në Zyrën e Përkrahjes Sociale".

Nga verifikimi i dokumentacionit gjatë mbikëqyrjes, rezultoi se nuk ishte bërë deklarimi i statusit të punësimit si nëpunës civil, sipas pikës 3 të nenit 67, për nëpunësen \*\*\*\*\* për pozicionin "specialist finance për buxhetin e kontabilitetin", në të cilin ajo ka qenë e punësuar në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Kjo punonjëse, me Urdhrin nr. 23, datë 05.03.2014, të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr.1, Tiranë, me nr. 552 prot., datë 05.03.2014, është emëruar në pozicionin "Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Ekonomike". Aktet që materializojnë procedurën e konkurrimit, janë të evidentuara në aneksin që i bashkëlidhet këtij raporti i emërtuar - **Aneks nr.3** "Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të cilët ishin punësuar nëpërmjet konkurimit.

**Konkluzion:** Komisioneri e vlerëson të drejtë veprimin e Sektorit të Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore, si njësia përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusit për punonjësit :

1. \*\*\*\*\* si nëpunës civil në pozicionin "Jurist",
2. \*\*\*\*\* si nëpunës civil në pozicionin "Specialist i informimit qytetar"
3. \*\*\*\*\* si nëpunës civil në pozicionin "Specialist i përkrahjes sociale".

Njësia përgjegjëse, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 05.03.2014 "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", pas verifikimit të kriterëve të fillimit të marrëdhënieve të punës për punonjësen \*\*\*\*\* duhet të kishte nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, në pozicionin që mbante punonjësja në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil.

Për të rregulluar pasojat në këtë rast, Komisioneri rekomandoi revokimin e Urdhrit nr. 23, dt. 05.03.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr.1, Tiranë, regjistruar me nr. 552 prot., datë 05.03.2014, pasi në kuptim të nenit 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, është një akt absolutisht i pavlefshëm që ka dalë në kundërshtim me ligjin dhe procedurat ligjore që rregullojnë institutin e ngritjes në detyrë dhe punonjësja duhet të kthehej në pozicionin e mëparshëm.

Komisioneri vëren se, në zbatim të rekomandimit të mësipërm, institucioni i mbikëqyrur ka nxjerrë aktin administrativ nr. 2468 prot, dt.07.07.2015, “*Akti i deklaramit të statusit të punësimit*” për punonjësen \*\*\*\*\* duke e deklaruar atë, nëpunëse civile, në pozicionin “*Ekonomiste në sektorin e Burimeve Ekonomike*”, pranë Njesisë Bashkiake Nr. 1, Tiranë.

Ndërsa lidhur me revokimin e Urdhrit nr. 23, dt. 05.03.2014, të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr.1, Tiranë, rregjistruar me nr. 552 prot., datë 05.03.2014, Komisioneri çmon se ky akt duhet të revokohet, ashtu si është rekomanduar edhe në projektraportin dërguar Njesisë Bashkiake Nr.1, Tiranë, duke vlerësuar se pozicioni i punës “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Ekonomike*” duhet të konsiderohet si pozicion i lirë, në kuptim të ligjit dhe si i tillë, duhet të plotësohet në përputhje me procedurat që parashikohen në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, për lëvizjen paralele apo ngritjen në detyrë.

2.2 Nëpunës, të pranuar në shërbimin civil si “nëpunës ekzistues” sipas përcaktimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil”

Në institucionin e mbikëqyrur, rezulton vetëm 1 rast kur punonjësi ka përfutuar statusin e nëpunësit civil si punonjës ekzistues, pasi hyrja në fuqi e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i Nëpunësit Civil*”, e ka gjetur në pozicion pune që konsiderohej pjesë e shërbimit civil. Në zbatim të nenit 27 të ligjit të sipërpërmendur, pas periudhës së provës dhe në përfundim të saj ky punonjës është konfirmuar nëpunës civil. Bëhet fjalë për punonjësen \*\*\*\*\* e cila me Vendimin nr. 1, datë 25.03.2002, është konfirmuar nëpunës civil në pozicionin “*Specialiste Finance për Buxhetin e Kontabilitetin*”. Për pasojë, rezulton se njësia përgjegjëse, ka formalizuar deklaramin e statusit të nëpunësit civil për këtë punonjëse në pozicionin “*Llogaritar - Arkëtar*”, me aktin e deklaramit të statusit të punësimit me nr. 1853/1 prot datë 15.03.2014, të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr.1 Tiranë.

Ajo çka u konstatua në këtë rast, është fakti se, në momentin e konfirmimit si nëpunëse civile, emërtesa e pozicionit të punës për këtë punonjëse, është në përputhje me ligjin, në nivelin “*specialist*”, ndërsa në rrethanat konkrete, konfirmimi është në një pozicion që nuk parashikohet me këtë emërtesë në ligjin aktual “*Llogaritar - Arkëtar*”.

Në këto rrethana, njësisë përgjegjëse i lind si detyrë të ekuivalentojë pozicionin, në këtë rast “*Llogaritar - Arkëtar*”, me nivelin përkatës sipas ligjit.

**Konkluzion:** Arrijmë në përfundimin se njësia përgjegjëse, ka vepruar drejt në nxjerrjen e aktit të deklaramit të statusit të punësimit me nr. 1853/1 prot datë 15.03.2014 për deklaramin e statusit “*nëpunës civil*” për nëpunësen \*\*\*\*\* por duhet të njehsojë pozicionin e punës “*Llogaritar - Arkëtar*”, me emërtesën e pozicionit sipas ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Komisioneri konstaton se, në vlerësim të orientimeve të grupit të mbikëqyrjes të shprehura nëpërmjet projektraportit, për njehsimin e pozicionit të punës “*Llogaritar - Arkëtar*” me emërtesën e pozicionit, sipas ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, institucioni është kujdesur në përmbushjen e këtij rekomandimi dhe ka materializuar këtë veprim administrative, nëpërmjet Urdhrit nr.57, dt. 07.07.2015 të titullarit të institucionit.

### 2.3 Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë të emëruar me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"

Nga shqyrtimi i dokumentave të këqyrrur dhe administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se në këtë institucion, në 5 raste janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, duke mos respektuar procedurat e pranimit në shërbimin civil, si dhe procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë sikurse përcaktohej në nenin 13 e vijues të ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Ndonëse dispozitat ligjore në fjalë përcaktonin procedurat e pranimit në shërbimin civil dhe të lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, marrëdhëniet e punës për këta punonjës efektivisht janë rregulluar sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë dhe bëhet fjalë për këto raste:

- Punonjësja \*\*\*\*\* me Urdhrin nr. 30, dt. 12.12.2013, është emëruar në pozicionin "specialiste në Sektorin e Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban", deri në realizimin e konkursit për këtë qëllim. Me vendimin nr. 3063/1, dt. 28.04.2014 "Për deklarimin e statusit të punësimit" është deklaruar nëpunëse civile në periudhë prove, që nga data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ndërsa me Urdhrin nr. 14, dt. 02.03.2015, të Kryetarit të Njësisë Bashkiake nr 1, Tiranë, i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil në pozicionin "Specialiste në Sektorin e Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban".
- Punonjësja \*\*\*\*\* me Urdhrin nr. 9, dt. 30.01.2014, është emëruar në pozicionin "Përgjegjëse e Zyrës së Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale", deri në realizimin e konkursit për këtë pozicion. Me vendimin nr. 248/1, dt. 28.04.2014 është deklaruar nëpunëse civile në periudhë prove, që nga data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ndërsa me Urdhrin nr. 22, datë 28.04.2015, i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil, në pozicionin "Përgjegjëse e Zyrës së Përkrahjes Sociale".
- Punonjësja \*\*\*\*\* me Urdhrin nr. 2, dt. 06.01.2014, është emëruar në pozicionin "Specialiste në Zyrën e Përkrahjes Sociale". Me vendimin nr. 14/1 prot. datë 28.04.2014, është deklaruar nëpunëse civile në periudhë prove, që nga data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ndërsa me Urdhrin nr. 16, datë 02.03.2015, me nr. 901 prot. datë 02.03.2015, i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil në pozicionin "Specialiste në Zyrën e Përkrahjes Sociale".
- Punonjësi \*\*\*\*\* me Urdhrin nr. 18, datë 11.02.2014, është emëruar në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban" deri në realizimin e konkursit për këtë pozicion. Me vendimin nr. 381/1, datë 28.04.2014 është deklaruar nëpunës civil në periudhë prove që nga data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ndërsa me Urdhrin nr. 21, dt. 02.03.2015, me nr. 906 prot. datë 02.03.2015, i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban".
- Punonjësja \*\*\*\*\* e cila me Urdhrin "Për emërim provizor" nr. 09/2014 me nr. 127 prot. datë 17.01.2014, është emëruar në pozicionin "Specialist për taksat" deri në realizimin e konkursit për këtë pozicion. Me vendimin nr. 127/1 prot. datë 28.04.2014 është deklaruar nëpunës civil në periudhë prove që nga data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ndërsa me Urdhrin nr. 23, datë

02.03.2015, me nr. 908 prot. datë 02.03.2015, i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil në pozicionin “Specialiste e Taksave në Sektorin e Burimeve Ekonomike”.

Nisur nga përmbajtja e pikës 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve përkatëse, rezultoi se, në rastet e sipërpërmendura, për punonjësit që mbanin këto pozicione pune në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me vendimet respektive të datës 28.04.2014, është realizuar procesi i deklarimit të statusit të punësimit, në kategorinë e nëpunësit civil në periudhë prove dhe në vijim të këtij procesi, në datën 02.03.2015, këta punonjës janë konfirmuar si nëpunës civil.

Nisur nga përmbajtja e nenit 24 dhe 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Kreut VI, “Periudha e provës” të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, vendimi i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil në përfundim të periudhës së provës merret bazuar në:

- a. Rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASP);
- b. Vlerësimin të rezultateve individuale në punë, i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor që rregullon institutin e vlerësimit të arritjeve vjetore.

Nga verifikimi i dosjeve të personelit, në momentin e mbikëqyrjes, rezultoi se asnjë nga nëpunësit e sipërpërmendur, të cilët janë deklaruar në periudhë prove, me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk kishin ndjekur ciklin e detyrueshëm të trajnimit në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASP). Për pasojë, në rrethanat kur nuk është plotësuar njëri prej elementëve më të rëndësishëm ligjorë, grupi i punës rekomandoi revokimin e urdhërave përkatës të konfirmimit si nëpunës civil për nëpunësit \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* dhe shtyrjen e periudhës së provës, si dhe marrjen e masave që këta punonjës të përfundojnë dhe të vlerësohen për trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike (ASP).

**Konkluzion:** Nga sa analizuam më sipër, në kuptim të nenit 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe VKM-së nr. 116 datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt duke i konsideruar nëpunësit e cituar më sipër si nëpunës civil.

Por, nga ana tjetër, ashtu si e argumentuam më sipër, për shkak se në kuptim të nenit 115, e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, akti i konfirmimit për nëpunësit civilë të deklaruar në periudhë prove, është një akt absolutisht i pavlefshëm, që ka dalë në kundërshtim me ligjin dhe procedurat ligjore që rregullojnë institutin e periudhës së provës, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe për këtë arsye grupi i punës në projektraportin dërguar institucionit të mbikëqyrur, ka ojejtuar institucionin se aktet administrative të listuara më poshtë, duhet të revokohen.

- Urdhri nr. 14, me nr.899 prot., datë 02.03.2015, me të cilin punonjës \*\*\*\*\* i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban” ;
- Urdhri nr. 22, datë 28.04.2015, me nr. 907 prot datë 28.04.2015, me të cilin punonjës \*\*\*\*\* i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil, në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës së Përkrahjes Sociale”;
- Urdhri nr. 16, datë 02.03.2015, me nr. 901 prot. datë 02.03.2015, me të cilin punonjës \*\*\*\*\* i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil, në pozicionin “Specialiste në Zyrën e Përkrahjes Sociale”;
- Urdhri nr. 21 datë 02.03.2015 me nr. 906 Prot datë 02.03.2015, me të cilin \*\*\*\*\* i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban” ;
- Urdhri nr. 23 datë 02.03.2015, me nr. 908 prot datë 02.03.2015, me të cilin punonjës \*\*\*\*\* i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil në pozicionin “Specialiste e taksave në Sektorin e Burimeve Ekonomike”

#### 2.4 Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë emëruar me akte emërimi të përkohshme pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, konstatohet se në 5 raste në këtë institucion janë emëruar punonjës në pozicione pune të shërbimit civil me akte emërimi të përkohshme. Bëhet fjalë për punonjësit:

- \*\*\*\*\* i cili me Urdhri nr. 44 datë 25.07.2014, me nr.1889 prot. datë 25.07.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr.1, Tiranë, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore”, deri në realizimin e konkursit për këtë pozicion;
- \*\*\*\*\* e cila me Urdhri nr. 23, datë 05.03.2014, me nr. 552 prot. datë 05.03.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr.1, Tiranë është emëruar në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Ekonomike” deri në realizimin e konkursit për këtë pozicion (ashtu si u analizua në kapitullin e deklaramit të statusit të punësimit);
- \*\*\*\*\* e cila me Urdhri nr. 27, datë 19.03.2014, me nr. 688 prot. datë 19.03.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr.1, Tiranë, është emëruar në pozicionin “Ekonomiste në Sektorin e Burimeve Ekonomike”, deri në realizimin e konkursit për këtë pozicion;
- \*\*\*\*\* i cili me Urdhri nr. 79, datë 02.12.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr.1, Tiranë, është emëruar në pozicionin “Specialist Infrastrukture në Sektorin e Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban”, deri në realizimin e konkursit për këtë pozicion;
- \*\*\*\*\* e cila me Urdhri nr. 117, datë 28.02.2014 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, është emëruar në pozicionin "Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve në NJBI", deri në përfundim të procedurave të konkursit për këtë pozicion.

Grupi i mbikëqyrjes konstaton se aktet e sipërpërmendura kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, apo për plotësimin e vendeve të lira të punës në kategorinë e ulët drejtuese sipas nenit 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht

kërkesat e një procedure të rregullt ligjore. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

**Konkluzion:** Në këto rrethana, Komisioneri çmon se aktet administrative të evidentuara më sipër, në kuptim të nenit 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, janë akte absolutisht të pavlefshëm, pasi kanë dalë në kundërshtim me ligjin dhe me procedurën e kërkuar nga ligji nr.152.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Komisioneri me qëllim rregullimin e situatës i rekomandon Njesisë Përgjegjëse revokimin e akteve administrative të cituara më sipër.

Këto pozicione duhet të konsiderohen si pozicione të lira dhe duhet të plotësohen nëpërmjet procedurave ligjore, sipas rastit, konkurim, lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

2.5. Pozicione pune që përfshihen për herë të parë në fushën e veprimit të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Ashtu si analizuam në hyrje të këtij materiali, pjesë e strukturës së Njesisë Bashkiake nr. 1, Tiranë është edhe Zyra e Gjendjes Civile.

Nga këqyrja e dokumentacionit përkatës rezulton se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, në Zyrën e Gjendjes Civile pranë Njesisë Bashkiake Nr 1, Tiranë kanë qenë të punësuar këta punonjës:

- \*\*\*\*\* Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile;
- \*\*\*\*\* Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile;
- \*\*\*\*\* Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile;
- \*\*\*\*\* Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile.

Aktualisht, në momentin që është realizuar procesi i mbikëqyrjes në Zyrën e Gjendjes Civile pranë Njesisë Bashkiake Nr 1 Tiranë janë të punësuar punonjësit si më poshtë:

- \*\*\*\*\* Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile;
- \*\*\*\*\* Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile;
- \*\*\*\*\* Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile;
- \*\*\*\*\* Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile.

Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile, në Njësitë Bashkiake nr. 1, Tiranë, deri në datën 26.02.2014, janë rregulluar sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përfshin në skemën e shërbimit civil edhe Zyrat e Gjendjes Civile, në Njësitë Bashkiake, pasi, në nenin 2 të tij, parashikohet në mënyrë të

shprehur se, fusha e veprimit të ligjit përfshin çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

Më tej, në nenin 65 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 "*Për gjendjen civile*", përcaktohet se, rekrutimi i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile bëhet mbi bazën e kriterëve dhe procedurave konkurruese, të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, që është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile dhe një institucion që ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr. 8549/1999 "*Statusi i nëpunësit civil*".

Pra, duke patur parasysh faktin që, emërimi i punonjësve të shërbimit të gjendjes civile, kryhet mbi bazën e një procedure konkurruese të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549/1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", si dhe përfshirjen e këtyre pozicioneve në kategorinë e funksioneve që ushtrojnë autoritet publik, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, kjo strukturë duhet të përfshihet në shërbimin civil.

Për punonjësit e punësuar në këto pozicione pune, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, njësia përgjegjëse, duhet të kishte bërë verifikimin e plotësisht të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe të deklaronte statusin e punësimit.

Gjithashtu, për pozicionet e punës së Zyrës së Gjendjes Civile, ashtu si dhe për pozicionet e tjera të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk ka hartuar përshkrimet e reja të punës, sipas formatit standard të miratuar, siç përcaktohet në aktin përkatës nënligjor.

Aktet rregullative të shërbimit të gjendjes civile, përcaktojnë se shërbimi i gjendjes civile ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile, përcaktohet me akt nënligjor nga Këshilli i Ministrave.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile si organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile, realizon drejtimin metodik dhe kontrollon veprimtarinë e zyrave të shërbimit të gjendjes civile. Emërimi në detyrë i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, realizohet nga kryetari i njësisë bashkiake, sipas kriterëve të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe lirimi nga detyra i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, është kompetencë e kryetarit të njësisë bashkiake, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Sipas sqarimeve të dhëna nga njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, faktin që nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil për këtë kategori nëpunësish, e argumenton me pretendimin se menaxhimi i kësaj zyre, lidhur me rregullat, kushtet dhe procedurat e pranimit të nëpunësve në shërbimin e gjendjes civile, administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Neni 7, pika 2, i ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar, ka përcaktuar detyrat e Departamentit të Administratës Publike, ndër të cilat, në gërmën "f" të kësaj dispozite, në mënyrë të shprehur përcaktohet se Departamenti i Administratës Publike "*mbështet dhe siguron këshillimin e institucioneve në zbatim të këtij ligji*".



Pas konstatimeve të shprehura në projektraport dhe nga shqyrtimi i akteve të paraqitura nga institucioni i mbikëqyrur, me shkresën nr. 2425/1, dt.07.07.2015 “Mbi projekt-raportin e mbikëqyrjes në Njësinë Bashkiake nr.1, Tiranë”, Komisioneri konstaton se, nga ana e subjektit është nxjerrë akti i deklarimit të statusit të punësimit për 3 punonjës të Zyrës së Gjendjes Civile, përkatësisht:

- Me shkresën nr. 2469 prot., dt.07.07.2015 “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, \*\*\*\*\* është deklaruar “nëpunëse civile”, në pozicionin Specialiste e Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njësisë Bashkiake nr. 1, Tiranë.
- Me shkresën nr. 2470 prot., dt.07.07.2015, “Akti i deklarimit të Statusit të punësimit”, \*\*\*\*\* është deklaruar “nëpunëse civile”, në pozicionin Specialiste e Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njësisë Bashkiake nr. 1, Tiranë.
- Me shkresën nr. 2469 prot., dt.07.07.2015, “Akti i deklarimit të Statusit të punësimit”, \*\*\*\*\* është deklaruar “nëpunëse civile”, në pozicionin Përgjegjëse e Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njësisë Bashkiake nr. 1, Tiranë.

**Konkluzion:** Nisur nga përmbajtja e project raportit për këtë rast, Komisioneri vlerëson se, institucioni i mbikëqyrur, është orjentuar që këtë veprim ta kryej në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (që është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile) dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme (sekretari i përgjithshëm është organi që vjen menjëherë si epror i Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile) dhe Departamentin e Administratës Publike, me qëllim që të qartësohet pozicioni i nëpunësve të gjendjes civile, në raport me shërbimin civil dhe më tej, të vijonin procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësit që kanë mbajtur këto pozicione pune në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 67, të tij, si dhe VKM-së nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Për këtë arsye, edhe pse vlerëson faktin e reagimi në kohë të subjektit të mbikëqyrur , duke deklaruar aktet e punësimit për nëpunësit e cituar më sipër, Komisioneri çmon se ky veprim duhet të ishte realizuar pasi të materializohej bashkëpunimi ndër institucional si dhe pasi të verifikohej statusi si dhe plotësimi i kushteve të punësimit nga ana e këtyre nëpunësve.

Komisioneri vlerëson se, në pozicionin e punës “Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”, ka qenë punonjësi \*\*\*\*\* i cili, ashtu si e parashtruar më sipër, e ka mbajtur këtë pozicion, deri në datën 25.07.2014 dhe më pas, në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore”. Për këtë arsye, punonjësi \*\*\*\*\* duhet të rikthehet në pozicionin e mëparshëm.

Komisioneri konstaton se, me Urdhrin nr. 46, me nr 1891 prot., dt. 25.07.2014 “Për emërim në detyrë”, është emëruar si specialiste në Zyrën e Gjendjes Civile, punonjësja \*\*\*\*\* me një afat të kufizuar, deri në realizimin e konkursit.

Ky është një akt absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 23, pika 4, e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe si i tillë, ai duhet të revokohet.

### 3. Hartimi i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil.

Një institut shumë i rëndësishëm, i cili ka lidhje me një sërë institutesh të tjera të ligjit për nëpunësin civil, të tillë si rekrutimi, ristrukturimi, vlerësimi i punës, sistemi i karrierës etj., është edhe procesi i hartimit të përshkrimit të punës, për pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil.

Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014 i Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" dhe Udhëzimi i Departamentit të Administratës Publike nr.2, datë 07.04.2014 "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil", si akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, kanë përcaktuar qartë dhe me hollësi procedurat për hartimin e përshkrimit të punës, për çdo pozicion pune që përfshihet në shërbimin civil.

Përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave kryesore dhe përgjegjësi kryesore të pozicionit respektiv të punës, zgjidhjen e problemeve, vendimmarrjen, mjedisin menaxherial, mbikëqyrjen, stafin në varësi (*në rastet kur ka*), kushtet e punës dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës. Gjithashtu, kërkohet që rolet dhe aktorët që marrin pjesë në këtë proces, të jenë të përcaktuar qartë duke sjellë efikasitet në mënyrën e funksionimit të kërkuar procesi në tërësi, me qëllim realizimin e misionit të institucionit nga pikëpamja e metodologjisë së klasifikimit të një pozicioni në një kategori, klasë dhe grup të caktuar.

Nga verifikimi u konstatua se, për pjesën më të madhe të pozicioneve të punës, pjesë e shërbimit civil janë hartuar përshkrimet e punës, duke përdorur formatin standard të miratuar me Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" (formati standard i paraqitur në Lidhjen 4 bashkëlidhur këtij vendimi).

Mangësi u vërejtën në drejtim të përmbajtjes së akteve përkatëse të përshkrimit të punës, të cilat nuk rezultojnë të jenë plotësuar në përputhje të plotë me parashikimet e akteve nënligjore të sipërpërmendura, si dhe mangësi formale në disa raste, kur në këto akte mungonte nënshkrimi i nëpunësit civil, eprorit direkt të nëpunësit civil, si dhe i titullarit të institucionit.

Gjithashtu, për 4 pozicionet e punës që i përkasin Zyrës së Gjendjes Civile, nuk janë hartuar përshkrime pune, për shkak se kjo strukturë nuk trajtohej si pjesë e shërbimit civil.

**Konkluzion:** Komisioneri arrin në përfundimin se duke patur parasysh rëndësinë e veçantë që paraqet përshkrimi i punës, për çdo pozicion pune të shërbimit civil, në drejtim të kontrollit të aktivitetit të nëpunësit, si dhe vlerësimit të punës në fund të vitit kalendarik, por edhe si një detyrim ligjor që rrjedh nga ligji 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, njësia përgjegjëse në bashkëpunim me eprorët direkt, duhet të rishikojë dhe të plotësojë me të gjitha rubrikat sipas formatit standard të miratuar, formularët e përshkrimit të punës për pozicionet përkatëse, ashtu si përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe

*institucionet e pavarura* “ dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”.

**4. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2014 për nëpunësit civilë të Njesisë Bashkiake nr. 1 Tiranë dhe njëkohësisht se si është materializuar procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur nëpunësve kompetentë të këtij procesi, gjatë vitit të vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues*).

Grupi i punës verifikoi aktet administrative që kanë lidhje me këtë proces për të vërtetuar nëse procesi i vlerësimit është kryer sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit në subjektin e mbikëqyrur rezultoi se formulari që përdoret në këtë institucion për vlerësimin e rezultateve në punë është hartuar sipas formatit të miratuar sipas Lidhjes 2 të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”.

U konstatua se në përmbajtjen e këtij akti janë përfshirë të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (*ndarja A*); konteksti i punës për objektivat e institucionit dhe njesisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (*ndarja B*); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke patur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objekt specifik dhe të matshëm (*ndarja C*); sjellja profesionale, që ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer, realizimi në kohë, kolegjaliteti i marrëdhënieve dhe gadishmëria për punën në grup, shpeshtësinë e orëve të punës jashtë orarit, kërkesat për këshillim, trajnimi dhe ngritja profesionale (*ndarja Ç*); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet vlerësimi i përmbledhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se vlerësimi është realizuar për **18** nëpunës që mbajnë pozicione pune pjesë të shërbimit civil, të cilat përfaqësojnë pozicione të nivelit të ulët drejtues dhe pozicione të nivelit ekzekutiv.

Vlerësimet e rezultateve në punë për nëpunësit e nivelit ekzekutiv janë bërë nga përgjegjësit e sektorëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 109 dt. 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil*”.

Formulari standard i miratuar, vërehet të jetë plotësuar në pjesën më të madhe të rubrikave përkatëse dhe është nënshkruar nga nëpunësit e përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, si “*Zyrtari Raportues*”, “*Zyrtari Kundërfimues*” dhe “*Zyrtari Autorizues*”. Nga këqyrja e dokumentacionit nuk konstatohen raste të mosmarrëveshjeve midis “*Zyrtarit Autorizues*”

dhe/ose “Zyrtarit Kundërfimues dhe Zyrtarit Autorizues” në lidhje me nivelin e vlerësimit, apo raste të rivlerësimit nga zyrtari autorizues (ndarja DH), për shkak të pretendimeve në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë.

Procesi i vlerësimit për punonjësit e deklaruar “*nëpunës civilë*”, sikurse përcaktohet në pikën 2 të Kreut VI të Vendimit nr 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, përfshin përgjithësisht periudhën e vlerësimit janar, shkurt 2014 – dhjetor 2014, ndërsa për punonjësit e emëruar në vijim, periudha e vlerësimit shtrihet nga momenti i emërimit, deri në fund të muajit dhjetor 2014.

Por, ndërkohë që nga pikëpamja formale konstatohet çdo gjë në rregull, nga ana tjetër, duke analizuar përmbajtjen e procesit, u vu re se rreth 78 % e rasteve të vlerësuara, janë në nivelin 2 “*Mirë*”, ç`ka do të thotë se procesi është karakterizuar nga vlerësimi në një nivel të lartë për të gjithë punonjësit. Ky përfundim arrihet duke analizuar formularët e vlerësimit, ku vërehet se nga 18 raste për të cilat është bërë vlerësimi i rezultateve në punë, në 14 raste nëpunësit janë vlerësuar në nivelin 2 me vlerësimin “*Mirë*” dhe në 4 raste në nivelin 1 me vlerësimin “*Shumë Mirë*”.

Kjo mënyrë vlerësimi që përqendrohet kryesisht në dy nivelet e larta të vlerësimit, duke anashkaluar tërësisht dy nivelet e tjera të vlerësimit, nivelin 3 “*Kënaqshëm*” dhe nivelin 4 “*Jo mjaftueshëm*”, të krijon përshtypjen se procesi i vlerësimit cedon në drejtim të objektivitetit dhe njëkohësisht, krijon mundësinë e humbjes së interesit dhe motivimit të nëpunësve për të kryer punën me një nivel gjithnjë e më të lartë cilësie, në kushtet kur konstatojnë se vlerësimin “*shumë mirë*” dhe “*mirë*” e marrin pa dallim pothuajse gjithë nëpunësit civilë të institucionit.

Nga ana tjetër, edhe pse formulari i përdorur është hartuar sipas kërkesave ligjore, u konstatua se në 15 raste, nuk janë plotësuar të gjithë rubrikat përkatëse (nënndarjet) që përmban formulari standart i miratuar, ç`ka do të thotë që procesi i vlerësimit vjetor në këto raste nuk është i përfunduar.

**Konkluzion:** Duke e konsideruar procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, si një proces të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të karrierës, si dhe të motivimit të nëpunësit në realizimin me sukses të objektivave që lidhen me vendin e tij të punës, Komisioneri çmon se vlerësimet vjetore të rezultateve në punë duhet të realizohen për të gjithë nëpunësit që mbajnë pozicione pune pjesë të shërbimit civil, brenda afateve ligjore dhe të pasqyrojnë në hapësirat përkatëse, komentet dhe shpjegimet e nevojshme që bëhen për çdo nëpunës civil, me qëllim përmirësimin e punës në drejtim të përmbushjes së objektivave.

## **5. Organizimi i Dosjeve dhe Regjistrimit të Personelit**

### **a. Dosja e personelit.**

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjet individuale të personelit, si një kërkesë e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, rezulton se përgjithësisht janë të administruara dokumentat e identifikimit (*fotokopje e kartës së identitetit*); dokumenta që tregojnë për gjendjen civile (*çertifikata e gjendjes familjare*); dokumenta që vërtetojnë edukimin

arsimor (*diploma e shkollës së lartë dhe lista e notave*); dokumenta që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (*akti i emërimit*); vërtetimi i gjendjes gjyqësore (*dëshmia e penalitetit*); vërtetimi i gjendjes shëndetësore (*raporti mjeko-ligjor*); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (*certifikata kualifikimi*), etj.

U konstatua se dosjet individuale të nëpunësve janë pjesërisht të sistemuara, ruhen në kushte të përshtatshme në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, që është nëpunësi përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me pikën 4 të Kreut I, të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*".

Nga verifikimi i dosjeve të personelit në disa raste u vërejtën mangësi të lidhura me mungesën e raportit mjeko-ligjor, dëshmisë së penalitetit apo listës së notave. Plotësimi i këtyre kërkesave është shprehur në mënyrë të detajuar në **Aneksin nr. 2** "*Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në Njësinë Bashkiake nr. 1*", që është pjesë e këtij projektraporti. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer gjatë mbikëqyrjes, u konstatuan mangësi në drejtim të përfshirjes në dosje të fletës përkatëse të inventarit, apo fletës prezantuese të dosjes teknike.

Përfshirja e këtyre akteve në dosjen e individuale të nëpunësit civil kërkohet shprehimisht në pikën 3 të Kreut I, të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*" si dhe lidhjen 1 dhe 2, pjesë të këtij vendimi.

**Konkluzion:** Komisioneri rekomandon që dosjet e personelit të organizohen dhe plotësohen në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*", duke bërë pjesë të saj të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në aneksin **Aneksin nr. 2**, "*Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në Njësinë Bashkiake nr. 1*", që është pjesë e këtij projektraporti.

#### b. Regjistri i personelit

Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*".

Në kushtet kur nuk është bërë ende funksional regjistri qendror i personelit, përgjegjës për administrimin e të cilit është Departamenti i Administratës Publike, verifikimi u përqendrua në regjistrin shkresor të mbajtur nga njësia e burimeve njerëzore, nga ku rezultoi se të dhënat e pasqyruara reflektojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

## **6. Miratimi i planit vjetor të pranimit në shërbimin civil**

Administrimi i shërbimit civil mbështetet në planin vjetor të pranimit, i cili sikurse përcaktohet shprehimisht në nenin 18 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, miratohet dhe publikohet jo më vonë se muaji shkurt i vitit përkatës kalendarik.

Në zbatim të kësaj dispozite, Vendimi nr. 108 datë 26.02.2014 i Këshillit të Ministrave "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", ka përcaktuar rregullat dhe procedurat e hollësishme për miratimin e planit të pranimit në shërbimin civil.

Sikurse përcaktohet në këto dispozita, plani i pranimit në shërbimin civil për njësitë e qeverisjes vendore, duhet të miratohet dhe publikohet brenda muajit shkurt të vitit kalendarik, të përmbajë elementët e përcaktuar në pikën 2 të Vendimit nr. 108 datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", duke mbajtur në konsideratë mundësinë e krijimit të vendeve vakante për shkak të ligjit, krijimit të vendeve të reja të punës apo sipas rastit dhe arsye të tjera.

Institucioni objekt i mbikëqyrjes ka tejkalar afatin kohor të miratimit dhe publikimit të planit vjetor të pranimit, pasi ky i fundit është miratuar vetëm së fundmi me Vendimin Nr 6, datë 28.04.2015, me nr. 1610 prot, datë 28.04.2015 "Për miratimin e Planit vjetor për pranimin në Institucionin e Njësisë Bashkiake nr 1, pjesë të Shërbimit Civil për vitin 2015", nëpërmjet të cilit janë miratuar 4 pozicione të lira pune, nga të cilat 2 pozicione pune nëpunës të kategorisë së ulët drejtuese dhe 2 pozicione pune të kategorisë ekzekutive.

**Konkluzion:** Në këto kushte, duke patur parasysh parashikimet e nenit 18 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Vendimit nr 108, dt. 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", Komisioneri çmon se njësia përgjegjëse duhet të marrë masat e nevojshme që në të ardhmen të hartojë, miratojë dhe publikojë, brenda afateve ligjore, planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, duke marrë në konsideratë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në dispozitat e sipërpërmendura.

## **7. Rastet e rekrutimeve, transferimit të përkohshëm apo të përhershëm, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil".**

Sikurse u përmend më lart, nga ana e institucionit pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/ 2013 janë konstatuar 3 raste emërimesh në nivelin ekzekutiv dhe 2 raste emërimi në nivelin e ulët drejtues, të cilat nuk janë realizuar në përputhje me procedurat ligjore.

Në këto rrethana, nuk u konstatua asnjë rast, kur të jetë plotësuar pozicioni i punës nëpërmjet konkurimit, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, në përputhje me nenet 22, 23 dhe 26 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore përkatëse, si Vendimi nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese"; Vendimi nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese" dhe

Vendimi nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, emërimin dhe periudhën e provës në kategorinë ekzekutive”.

**8. Procedura e ndjekur nga institucioni në rastet e lirimit nga shërbimi civil për shkak të dorëheqjes apo për shkak të ligjit**

Nga këqyrja e strukturës analitike dhe listëprezencës e listëpagesës së muajit shkurt 2014, si dhe listëprezencës e listëpagesës në momentin e mbikëqyrjes, rezultoi se në 3 raste, punonjës që mbanin pozicione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk evidentohen si pjesë e strukturës analitike dhe listëprezencës e listëpagesës së muajit prill 2015. Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezultoi se largimi i tyre nga detyra ka qenë në 1(një) rast për shkak të dorëheqjes dhe në 2(dy) raste për shkak të ligjit (*plotësimi i moshës së pensionit të pleqërisë*) si më poshtë:

- \*\*\*\*\* – punonjëse që mbante pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve”. Marrëdhënia e punësimit për këtë punonjëse ka mbaruar për shkak të ligjit, pasi ka plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë. Lirimi nga detyra është bërë me Urdhrin nr. 41, datë 25.07.2014 “Për lirim nga detyra për shkak të ligjit (*plotësimi i moshës për pension pleqërie*)”.
- \*\*\*\*\* – punonjëse që mbante pozicionin “Specialiste Urbane në Sektorin e Infrastrukturës dhe Kontrollit Urban”. Marrëdhënia e punësimit ka mbaruar për shkak të ligjit, pasi ka plotësuar moshën për pension pleqërie. Lirimi nga detyra është bazuar në Urdhrin nr.76, datë 27.11.2014 “Për lirim nga detyra për shkak të ligjit (*plotësimi i moshës për pension pleqërie*)”.
- \*\*\*\*\* – punonjës që mbante pozicionin “Përgjegjës i Burimeve Ekonomike”. Marrëdhënia e punësimit ka mbaruar për shkak të dorëheqjes së paraqitur prej tij pranë Sektorit të Burimeve. Lirimi nga detyra është bazuar me Urdhrin nr. 19, datë 03.03.2014 “Për lirim nga detyra”.

Në bazë të dokumentacionit të administruar konstatohet se në referencë të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, këta punonjës janë nëpunës civil për shkak të ligjit, pasi kanë qenë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nisur nga këto rrethana, Komisioneri çmon që në të ardhmen, të kushtohet një kujdes i posaçëm për të gjetur dhe materializuar në aktet administrative, bazën ligjore përkatëse që rregullon një veprim juridik, dhe konkretisht në këtë rast, lirimin nga shërbimi civil.

**9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore**

Nga verifikimi i dokumentacionit të përfshirë në dosjet individuale të personelit, por edhe nga sqarimet dhe deklaratimet e personit të kontaktit, që në këtë rast është Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, ashtu si është pasqyruar në procesverbalin administrativ të datës 08.05.2015, të mbajtur midis grupit të mbikëqyrjes dhe përfaqësuesit të subjektit në këtë rast, rezultoi se pas momentit të fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar, nuk ka patur dhe nuk janë zhvilluar procedura disiplinore për nëpunësit që mbajnë pozicione pune pjesë të shërbimit civil.

U konstatua se nuk është ngritur Komisioni Disiplinor i parashikuar nga neni 59 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 115 dt. 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, me pretendimin se nuk ka pasur kërkesa për fillimin e ecurisë disiplinore.

Ndërkohë, referuar përsëri përmajtjes së dispozitave që kemi cituar në paragrafin më sipër, të cilat rregullojnë përbërjen dhe funksionimin e Komisionit Disiplinor, tashmë ky mekanizëm është një komision i përhershëm, i cili duhet të ngrihet që në fillim të vitit kalendarik dhe duhet të jetë funksional përgjatë gjithë vitit.

Në kuadër të rekomandimeve të reflektuara në projektraportin dërguar subjektit nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Njësia Bashkiake Nr. 1, Tiranë, në aktet e dërguara në përgjigje të projektraportit, me Urdhrin nr. 56, datë 07.07.2015, nr.2472 prot. “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, ka materializuar Ngritjen e Komisionit Disiplinor, por konstatohet se ai ka në përbërje 3 anëtarë.

Komisioneri vlerëson se subjekti i mbikëqyrur, në këtë rast duhet të marrë në konsideratë përcaktimet në pikës 3 të Kreut I të VKM-së nr. 115 dt. 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, ku përbërja e Komisionit disiplinor është me 5 anëtarë, pasi njësitë bashkiake trajtohen në një nivel me bashkinë në njësitë e qeverisjes vendore.

**10. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.**

Administrimi i shërbimit civil, është një proces i rëndësishëm, i cili duhet të realizohet duke u drejtuar nga ligji, për të siguruar respektimin e parimeve të këtij procesi, që synojnë në vendosjen e palëve përballë shanseve të barabarta, zhvillimin e një karriere të bazuar në meritë, mosdiskriminimin e palëve në proceset e administrimit, profesionalizmit të administratës, sigurimin e transparencës dhe paanësisë politike, si dhe të garantohet qëndrueshmëria në detyrë e nëpunësit civil dhe vazhdimësia në shërbimin civil.

Ndonëse efektet e ligjit për nëpunësin civil kanë filluar prej më shumë se një viti, nga ana e njësisë përgjegjëse pranë Njësies Bashkiake nr.1, Tiranë, konstatohet një harmonizim vetëm pjesërisht me parashikimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Pavarësisht faktit që korniza ligjore e cila rregullon fushën e shërbimit civil është plotësuar, duke përcaktuar me qartësi kushtet dhe hapat që duhet të ndërmarrin institucionet shtetërore që i nënshtrohen fushës së zbatimit të tij, përsëri vërehet zbatim jo i plotë i ligjit nga ana e institucionit të mbikëqyrur.



Në këtë kontekst konstatohet se, ndonëse janë bërë përpjekje për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, në disa raste nuk janë respektuar e përmbushur plotësisht normat dhe standardet e përcaktuara në ligj. Konstatohet se në disa raste, nga ana e institucionit është bërë një interpretim jo i saktë i ligjit nr. 152/2103 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Këto mangësi u konstatuan në drejtim të rasteve kur nuk ka përfunduar procesi i deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit pjesë e shërbimit civil, mangësi të hartimit të përshkrimeve të punës apo formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë, në formë e përmbajtje.

Ashtu si u parashtrua më sipër, ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcakton procedurën e konkurrimit si mënyrën e vetme të pranimit në shërbimin civil në pozicionet e nivelit ekzekutiv, por edhe në rastet e ngritjes në detyrë. Në këto kushte, ligji e ndalon emërimin me akte emërimi pa zhvilluar konkurimin, apo emërimin duke aplikuar kontrata të përkohshme punësimi, sipas Kodit të Punës, duke e përcaktuar shprehimisht se këto akte, janë absolutisht të pavlefshme, ç`ka nuk është mbajtur parasysh në të gjitha rastet nga njësia përgjegjëse.

Njësia përgjegjëse duhet të përfaqësojë një nivel më të lartë ndërgjegjësimit dhe përgjegjësie, jo vetëm në planifikimin e vendeve të lira në shërbimin civil, por edhe në rritjen e nivelit të bashkëpunimit me institucione të tjera, që janë pjesë e skemës së administrimit të shërbimit civil dhe që luajnë një rol të rëndësishëm në administrimin e shërbimit civil, si Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla e Administratës Publike (ASPA).

Një bashkëpunim më i ngushtë i njësisë përgjegjëse, kërkohet edhe me nëpunësit civil të institucionit, me qëllim identifikimin e nevojave të tyre për trajnim, duke shfrytëzuar dhe rrugët e bashkëpunimit me Shkollën e Administratës Publike, apo edhe mundësi të tjera, të cilat sjellin ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të nëpunësve të institucionit në të gjithë drejtimit e kërkuar nga ligji.

Nisur nga rrethanat e reja në të cilat do të vijojë administrimi i shërbimit civil në institucionet e administratës vendore, në kuadër të riorganizimit të pushtetit vendor, del si domosdoshmëri që subjekti të ketë identifikuar saktë nëpunësit, të cilët përfitojnë nga ligji 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi ata gëzojnë të gjitha të drejtat e sanksionuara në këtë ligj, si dhe të ketë të administruar në dosjen personale të nëpunësit civil, të gjithë dokumentacionin që materializon karrierën e tij në shërbimin civil.

\*  
\*   \*

Këto ishin konstatimet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Institucionin, Njësia Bashkiake nr.1 Tiranë, gjatë zbatimit të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Zbatimi i rekomandimeve të Komisionerit duhet të kryhet me koherencë të plotë të zhvillimeve që ndodhin për shkak të aplikimit të reformës territoriale, që prek edhe organizimin e njësive të qeverisjes vendore.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, janë materializuar në tabelat:

- **Aneksi nr.1** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me emërim të përkohshëm (data 26.02.2014)”;
- **Aneksi nr.2** “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion”;
- **Aneksi nr. 3** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të punësuar nëpërmjet konkurimit (data 26.02.2014)”.

## KOMISIONERI

**Pranvera STRAKOSHA**